


DUART E ARTA TË GAZETARËVE



DEMOKRACINË E RUAJNË QYTETARËT AKTIV

POEMA (11), RRUMEJSA (11), FATIME (11), ULIKS (12), ORGES (12), ALUIT (12), ERZA (12), EVELINA (11),
ALTINI (12), GERT (12), BLERON (11), TRIM (12)



Liria, barazia, toleranca, solidariteti, respekti janë disa parime kyçe të demokracisë, vlerën e të cilave do ta mësoni në artikullin tonë

Nëse flasim për demokracinë mund të marrim shumë shembuj. Mund të fillojmë duke u bazuar në fjalët: liri, drejtësi, barazi, respekt, tolerancë, etj. Ose mund të përmendim raportet që ne kemi me shokët dhe shoqet e klasës. Këto raporte janë të ndërtuara në besim re-



Po, po, ne informohemi për demokracinë dhe vlerën e saj

ciprok, mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit, tolerancë fetare, si dhe respekt të vazhduar ndaj njëri-tjetrit. Këto njëkohësisht janë edhe vlerat e demokracisë. E demokracia është formë e qeverisjes e bazuar në vetë zgjedhjet e popullit. Shembull i ngjashëm është edhe zgjedhja e kryetarit\es të klasës sonë, e cila ndodh me vetë dëshirën tonë. Ne e kemi zgjedhur personin më të mirë për të cilin mendojmë se do të jetë përfaqësuesi ynë

më i denjë.


Vlen të theksohet se niveli i demokracisë është rritur ndër vite, dhe kjo ka ndodhur falë qytetarëve aktiv. Pra, qytetaria aktive është e lidhur ngushtë me demokracinë, dhe këto të dyja nuk mund të funksionojnë pa njëra-tjetrën. Shembull për këtë është edhe puna vullnetare. Me vetë vullnetin tonë dhe përmes punës vullnetare ne mund të krijojmë gjëra të mëdha. Pa këto veprime, qytetaria aktive nuk do të kishte ndonjë kuptim.

Përveç këtyre, fjala qytetari aktive ka një përfshirje edhe më të gjerë. Pra, me qytetari aktive kuptojmë pjesëmarrjen në zgjedhje, aktivizimin, të paguarit e taksave, shpërndarjen e njohurive dhe informatave, e shumë e shumë veprime të tjera që besojmë që veçse keni njohuri për to.

Andaj, bëhuni aktiv gjithmonë. Të fillë ju kemi dhe kështu ju duam!




Gazetarët e këndshëm dhe simpantikë



Qytetarët aktiv e ruajnë dhe e mirëmbajnë ambientin e tyre jetësor



Ata i respektojnë të gjitha elementet e demokracisë me shumë përgjegjësi dhe vullnet



Sepse e dijnë se sa punë është bërë nga shumë qytetarë për të zhvilluar sistemin demokratik aty ku është sot



Ky sistem na siguron neve të drejta të barabarta pa marrë parasysh dallimet tona gjinore, etnike, racore, fetare, etj




Si dhe siguron mirëqenie sociale për të gjithë qytetarët pa asnjë dallim



Andaj, me tërë qenien tonë themi se ne jemi dhe gjithmonë do të mbesim zemra e demokracisë

FUQIA E VOTAVE TONA

ERJON E. (11), DIELLI (12), ELMA (12), ENDRIT (12), RIOLA (12), UARDA (11), ERI (11), JONA (12),
ARBENITA (12), ENDI (12), ERJON R. (12)



Ndoshta ju keni mësuar për zgjedhjet më parë. Por, pse duhet të votoni? Për këtë do t'iu tregojmë ne, në vijim

Këtë artikull dëshirojmë ta fillojmë me një shembull që sapo na ndodhi këtu, në Punëtorinë e Demokracisë. Kur u ulëm ta shkruajmë këtë artikull, detyra jonë e parë ishte të gjejmë një titull për të. Dikush nga ne propozoi titullin „Fuqia e votave tona“, dikush tjetër tha „Siguria e votave tona“. Erjoni vendosi që ta zgjidhim këtë dilemë, duke votuar. Kështu, ne filluam votimin dhe e zgjodhëm titullin e parë, sepse na pëlqeu më shumë. Ky është procesi i votimit.

Sot ne diskutuam me edukatoren tonë për procesin zgjedhor. Dy lloje të zgjedhjeve janë: zgjedhjet komunale ose lokale dhe zgjedhjet parlamentare ose qendrore. Zgjedhjet lokale janë ato zgjedhje ku qytetarët e një komune votojnë vetëm për kandidatët e asaj komune.

Në këto zgjedhje votojmë për kryetarin/en e komunës përkatëse i/e cili/a së bashku me disa përfaqësues të quajtur asamblistë. Së bashku me kryetarin/en ata punojnë në Kuvendin Komunal. Kurse, zgjedhjet parlamentare kanë të bëjnë me zgjedhjen e 120 deputetëve. Sipas ligjit, deputetët punojnë për 4 vjet në këtë detyrë, ashtu si edhe kryetari i komunës.

Para se t'ia besojmë votën tonë një kandidati të caktuar, ne duhet të mendojmë mirë. Gjithashtu, para se të votojmë ne duhet të dijmë shume gjëra për atë kandidat. Për shembull, çfarë ka studiuar, çfarë ka punuar më parë dhe cili është qëllimi i tij për të ardhmen e Kosovës. Ne mendojmë se një kandidat, i cili meriton votat tona duhet të jetë i zgjuar dhe punëtor. Për të votuar ne duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare për shkak se është qenësore pjekuria jonë mendore. Faleminderit për kohën tuaj.



Gazetarë të vegjël, por shumë profesional



Vetëm duke punuar shumë ndërtohet demokracia

PËRGJEGJËSIA NA TAKON NEVE

ERBLINA (14), ZOTRIM (12), ARBA (11) , ENEA (11) , ENSAR (11), MELISA (12), GRANIT (12),
ADONIS (11), AGON (12), ZIJA (13), RENGITA (12)



Kuvendi dhe rëndësia e ligjeve në jetën tonë si qytetarë


Kuvendi është institucion ligjvënës, i cili ndryshe njihet edhe si „Shtëpia e Popullit“. Përfaqësuesit e vendit të cilët i zgjedh populli me votën e lirë, janë deputetët. Pikërisht në Kuvend, deputetët marrin vendime shumë të rëndësishme për popullin. Aty miratohen ligje të shumta, që ndikojnë në jetën e secilit qytetar. Ligjet janë pjesë e pandashme jona dhe çdo qytetar i përgjegjshëm duhet t'i zbatojë ato. Nëse nuk respektohen ligjet, ndodhin shumë probleme që mund të sjellin pasoja jo të mira për vendin. Saherë kur ato nuk respektohen, pasojnë edhe ndëshkimet.

Pra, çdo ligj ka rëndësinë e vet. Rasti më i thjeshtë në jetën tonë të përditshme është ligji i komunikacionit rrugor. Çfarë do të ndodhte po të mos ishte ky ligj? Gjithsecili do të vepronte në mënyrën e vet në komunikacion. Për shembull, një vozitës do ta ngaste makinën me shpejtësi të madhe. Çdo kush do të ecte aty ku do të dëshironte dhe nuk do t'ia vinte veshin semaforit. Me të vërtetë do të bëhej një kaos i madh. Shembull tjetër mund të jetë ligji i ndalimit të pirjes së duhanit në vendet publike. Kur një person konsumon duhanin, ai/ajo nuk i shkakton dëm vetëm vetes, por edhe të tjerëve të cilët ndoshta nuk e pinë duhanin. Për këtë arsye, ndalohet pirja e duhanit në vende publike. Të gjitha këto ligje dhe shumë të tjera janë për të mirën tonë, andaj duhet të respektohen.

Po të mos ishin ligjet do të jetonim të pasigurtë, jo të

lirë dhe të pambrojtur.

Ne si fëmijë kemi një mesazh për ju, të dashur qytetarë: të respektojmë ligjet, sepse ato bëjnë që jeta jonë të jetë më e sigurt. Vetëm duke bërë një gjë të tillë ne do të ndihemi të lirë sikur pëllumbi që fluturon në qiell.



Në këtë vizatim është paraqitur një deputet, i cili po mban fjalimin e tij në foltore



Grupi „Superheronjtë në veprim“



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Yll Morina“
Klasa: VI-2
Vendi: Gjakovë